7. CASH POSITION (End of month) (4 minus 5)	Mijet në fund	1,588,470	1,577,960	1,567,450	1,556,940	1,546,430	1,644,720	1,743,010	1,841,300	1,830,790	1,820,280	1,809,770	1,799,260	

Monthly Cash Flow Projection
PISHINAT OLIMPIKE
Enter Date Here

ANALIZA E TË HYRAVE DHE DALJEVE 2016 - 2025 "KOMPLEKSI PISHINAT OLIMPIKE

		V. 2023												TOTAL
		Janar	Shkurt	Mars	Pri	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Novem	Dhjetor	
1. CASH ON HAND (Beginning of month)	Mijet në fillim	1,799,260	1,788,750	1,778,240	1,767,730	1,757,220	1,746,710	1,845,000	1,943,290	2,041,580	2,031,070	2,020,560	2,010,050	
2. CASH RECEIPTS							37,200	37,200	37,200					111,600
FISHIA E JASHTME OLIMPIKE							52,500	52,500	52,500					157,500
FISHIA PER REKREACION							6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	72,000
FISHIA E MIREUDSHKIE		6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	6,000	72,000
RESTAURANTI JASHTË		24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	288,000
RESTAURANTI MËYLLUR														
3. TOTAL CASH RECEIPTS (2a + 2b + 2c + 3)	Total Hyrjet	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000	143,700	143,700	143,700	50,000	50,000	50,000	50,000	701,100
4. TOTAL CASH AVAILABLE (Before cash out) (1 + 3)	Mijet Total	1,829,260	1,818,750	1,808,240	1,797,730	1,787,220	1,890,410	1,988,700	2,086,990	2,091,580	2,081,070	2,070,560	2,060,050	
5. CASH PAID OUT														
Shpenzimet e Pagave		7,700	7,700	7,700	7,700	7,700	12,600	12,600	12,600	7,700	7,700	7,700	7,700	107,100
Shpenzimet e Hafes		160	160	160	160	160	160	160	160	160	160	160	160	1,920
Shpenzimet e Mirembajtjes		600	600	600	600	600	600	600	600	600	600	600	600	7,200
Shpenzimet e Rrymes		4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	54,000
Shpenzimet e telefonit		50	50	50	50	50	50	50	50	50	50	50	50	600
Shpenzimet Bankare		12,500	12,500	12,500	12,500	12,500	12,500	12,500	12,500	12,500	12,500	12,500	12,500	144,000
Blerje te Mallit		12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	144,000
TOTAL DALJET		40,510	40,510	40,510	40,510	40,510	45,410	45,410	45,410	40,510	40,510	40,510	40,510	500,820
7. CASH POSITION (End of month) (4 minus 5)	Mijet në fund	1,788,750	1,778,240	1,767,730	1,757,220	1,746,710	1,845,000	1,943,290	2,041,580	2,031,070	2,020,560	2,010,050	1,999,540	

KOMPLEKSI I PISHINAVE NË FIDANISHTE

Monthly Cash Flow Projection
PISHINAT OLIMPIKE
Enter Date Here

ANALIZA E TË HYRAVE DHE DALJEVE 2015 - 2025 " KOMPLEKSI PISHINAT OLIMPIKE

		VITI 2024												TOTAL
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	November	Dhjetor	
1. CASH ON HAND	Mjetet në fillim	1,999,540	1,989,030	1,978,520	1,968,010	1,957,500	1,946,990	2,045,280	2,143,570	2,241,860	2,231,350	2,220,840	2,210,330	
2. CASH RECEIPTS														
PISHINA E JASHTIME OLIMPIKE	Hydrijet						37,200	37,200	37,200					111,600
PISHINA PËR REKREACION							52,500	52,500	52,500					157,500
PISHINA E NISRENDISHME		5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	72,000
RESTAURANT I JASHTE		24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	288,000
RESTAURANT I MBYLLUR		24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	288,000
3. TOTAL CASH RECEIPTS	Total Hydrijet	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000	143,700	143,700	143,700	30,000	30,000	30,000	30,000	701,100
4. TOTAL CASH AVAILABLE	(Before cash out) (1 - 3)	Mjetet Total	2,029,540	2,019,030	2,008,520	1,998,010	1,987,500	2,090,980	2,287,270	2,271,860	2,261,350	2,250,840	2,240,330	
5. CASH PAID OUT														
Shpenzimet e Pagave		7,700	7,700	7,700	7,700	7,700	12,900	12,900	12,900	7,700	7,700	7,700	7,700	107,100
Shpenzimet e Nafes		160	160	160	160	160	160	160	160	160	160	160	160	1,920
Shpenzimet e Mirëmbajtjes		600	600	600	600	600	600	600	600	600	600	600	600	7,200
Shpenzimet e Rrymës		4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	54,000
Shpenzimet e telefonit		50	50	50	50	50	50	50	50	50	50	50	50	600
Shpenzimet Bankare		15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	186,000
Blerje te Mallit		12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	144,000
TOTAL DALJET		40,510	40,510	40,510	40,510	40,510	45,410	45,410	45,410	40,510	40,510	40,510	40,510	500,820
7. CASH POSITION	Mjetet në fund	(End of month) (4 minus 6)	1,989,030	1,978,520	1,968,010	1,957,500	1,946,990	2,045,280	2,143,570	2,241,860	2,231,350	2,220,840	2,210,330	2,199,820

Monthly Cash Flow Projection
PISHINAT OLIMPIKE
Enter Date Here

ANALIZA E TË HYRAVE DHE DALJEVE 2016 - 2025 " KOMPLEKSI PISHINAT OLIMPIKE

		VITI 2025												TOTAL
		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	November	Dhjetor	
1. CASH ON HAND	Mjetet në fillim	2,199,820	2,189,310	2,178,800	2,168,290	2,157,780	2,147,270	2,245,560	2,343,850	2,442,140	2,431,630	2,421,120	2,410,610	
2. CASH RECEIPTS														
PISHINA E JASHTIME OLIMPIKE	Hydrijet							37,200	37,200	37,200				111,600
PISHINA PËR REKREACION								52,500	52,500	52,500				157,500
PISHINA E NISRENDISHME		5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	72,000
RESTAURANT I JASHTE		24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	288,000
RESTAURANT I MBYLLUR		24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	24,000	288,000
3. TOTAL CASH RECEIPTS	Total Hydrijet	30,000	30,000	30,000	30,000	30,000	143,700	143,700	143,700	30,000	30,000	30,000	30,000	701,100
4. TOTAL CASH AVAILABLE	(Before cash out) (1 - 3)	Mjetet Total	2,229,820	2,219,310	2,208,800	2,198,290	2,187,780	2,290,970	2,389,260	2,487,550	2,477,140	2,466,630	2,456,120	2,445,610
5. CASH PAID OUT														
Shpenzimet e Pagave		7,700	7,700	7,700	7,700	7,700	12,900	12,900	12,900	7,700	7,700	7,700	7,700	107,100
Shpenzimet e Nafes		160	160	160	160	160	160	160	160	160	160	160	160	1,920
Shpenzimet e Mirëmbajtjes		600	600	600	600	600	600	600	600	600	600	600	600	7,200
Shpenzimet e Rrymës		4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	54,000
Shpenzimet e telefonit		50	50	50	50	50	50	50	50	50	50	50	50	600
Shpenzimet Bankare		15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	15,500	186,000
Blerje te Mallit		12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000	144,000
TOTAL DALJET		40,510	40,510	40,510	40,510	40,510	45,410	45,410	45,410	40,510	40,510	40,510	40,510	500,820
7. CASH POSITION	Mjetet në fund	(End of month) (4 minus 6)	2,189,310	2,178,800	2,168,290	2,157,780	2,147,270	2,245,560	2,343,850	2,442,140	2,431,630	2,421,120	2,410,610	2,400,100

PËRSHKRIMI URBANISTIKO - ARKITEKTONIK I PROJEKTIT

Emri i projektit: **KOMPLEKSI I PISHINAVE**

Lokacioni: **MITROVICË** - Fidanishte buzë segmentit të lumit Ibër

Pronari i tokës: KUVENDI KOMUNAL - MITROVICË dhe HIDROEKONOMIA E UJËRAVE

Lloji i investimit: VALORIZIMI STRATEGJIK I KAPACITETEVE EKZISTUESE AMBIENTALE

Lloji i ndërtimit: NDËRTIMI I ULËT DHE I MESËM - KOMPLEKSI I PISHINAVE

Mënyra e realizimit: në FAZA (Faza: I; II; III dhe IV)

1. HYRJE

Mitrovica për dekada të tëra ishte qendër industriale me një zhvillim të gjithanshëm shoqëror, ekonomik, arsimor, kulturor etj. Duke u nisur nga ky fakt shtrohet arsyeja e dhe nevoja e krijimit të klimës së investimeve në fusha të ndryshme në mënyrë që brenda një periudhe kohore optimale ti rikthehet qytetit tonë shkëlqimi i humbur që dikur e kishte me krenari. Në këtë aspekt konsiderohen dhe duhet pranuar si hap shumë i rëndësishëm edhe investimet në lëmin e veprimtarisë së rekreacionit dhe sportit. Duke pasur parasysh faktin se në këtë kohë Mitrovica ka nevojë të madhe për këtë veprimtari, me qëllim të plotësimit të nevojave për qytetarët sportist dhe qytetarët tjerë të cilët sportin e kanë për rekreim. Prandaj këto qëllime shtrojnë nevojat dhe arsyet strategjike për plotësimin e përmbajtjes së ZONËS REKREATIVIO - SPORTIVE buzë lumit Ibër me KOMPLEKSIN E PISHINAVE .

Kompleksi i pishinave do ketë përmbajtje poli-funksionale për nevojat vitale të sportistëve dhe banorëve të qytetit të Mitrovicës me rrethinë si dhe të atyre që frekuentojnë qytetin dhe njekohësisht do ta plotësoi dhe pasuroi programin e rregullimit të shtratit të lumit - liqenit akumulues në Lumin Ibër.

Të gjitha gjërat e lartpërmendura të japin me dije arsyeshmërinë e investimit në këtë lëmi, gjegjësisht projektimin dhe ndërtimin e objekteve në fjalë.

2. QËLLIMI PARËSOR DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Qëllimi parësor i projektit është:

PËRMIRËSIMI, NGRITJA DHE RUAJTJA E KUSHTEVE AMBIENTALE TË QYTETIT

Ambienti që ofron vija gjatësore e lumit Ibër si dhe zona përreth që e përshkon lumin Ibër, paraqesin një margaritar të llojit të vetë e që me tërë këtë peizazh natyror, me liqenin akumulues dhe me kompleksin e pishinave do t'ia rrisin edhe më shumë vlerën ambientale dhe përmbajtësore qytetit.

Kompleksi i pishinave përfshinë një sipërfaqe tokësore prej rreth 4 hektarësh e cila përveq rregullimit të zonës në aspektin urban dhe arkitektonik do të ndikoi edhe në aspektin e përmirësimit - rregullimit të gjendjes faktike të sferës sociale me interes komunikimi ndërmjet njerzve dhe komuniteteve që gravitojnë në zonë.

3. ASPEKTI SPORTIV-REKREATIV

- SHOQËRIMI DHE REKREIMI I QYTETARËVE
- PREGADITJET FIZIKE PËR SPORTISTËT
- SHIJIMI I PASURIVE AMBIENTALE

Është komponentë shumë e rëndësishme e punimit të liqenit ku kemi nevojën e realizimit të sporteve ujore të notimit në disiplina të ndryshme. Parashihet të jetë me përmbajtje të disiplinave edhe Olimpike, me karakter regjional. Përgatitjet fizike të sportistëve, shijimi i ambienteve natyrore, seditja, janë poashtu elemente shtesë në aspektin e realizimit të funksioneve jetësore dhe sportive.

4. ASPEKTI SOCIAL-EKONOMIK

- PUNËSIMI I PERSONELIT (për mirëmbajtje)
- VETËDIJSIMI PËR RUAJTJEN E MJEDISIT

Motivet socio - ekonomike për funksionimin e Kompleksit të pishinave paraqesin komponentë shtesë. Këtu ngërthehen shumë veprimtari si punësimi, vetëdija, mjedisi, etj.

5. ANALIZA E SITUACIONIT

Lokacioni i propozuar i kompleksit të pishinave është në distancë optimale me qendrën e qytetit dhe lagjet tjera me rendesi. Lokacioni i destinuar gjendet mu pranë aksit rrugor të projektuar, me rrjetë të instalimit të rrymës elektrike, instalimit të ujësjellësit dhe kanalizimit të cilat gjenden në afërsi të drejtpërdrejtë.

Me kalimin e kohës dhe vetë transformimit të kahjeve të zhvillimit të qytetit, kjo zonë ka filluar të merr karakter tjetër dhe me të madhe dhe shumë shpejt do të merr karakter të rekreimit, zhvillimit të sportit, afarizmit si dhe plotësimit me përmbajtje tjera shoqërore, hotelerie, etj. Duke pas parasysh perspektivën e kësaj zone të qytetit si dhe vetë infrastrukturën që ekziston apo që në të ardhmen e afërt pritet të bëhet, plotësimi i kësaj veprimtarie edhe me objektet në fjalë, arsyetojnë investimet.

6. KONCEPTI I ZGJIDHJES DHE FORMËSIMI URB-ARKITEKTONIK

Për konceptin e zgjidhjes u nisem nga ideja që kompleksi të ketë formën e lirë me mundësi reale që të integrohet dhe përshtatet në teren si një teresi organike. Kjo hapësirë me pozitën e vetë mundëson zhvillim normal të aktiviteteve rekreative - sportive me orientim dhe insolim të mire dhe me mundësi të përshtatjes në ambient.

Nisur nga formimi i komponimit të vëllimeve si dhe formësimit të tërësishëm arkitektonik të ambientit përreth, objektet në fjalë, nuk dalin jashtë kornizave të arkitekturës tradicionale, gjë që ishte edhe pikënisje në komponimin e tërësishëm arkitektonik, prandaj KOMPLEKSI I PISHINAVE paraqet formësim të organizimit funksional të përmbajtjeve polifunksionale të kategorive të agëtimit, pushimit, zbavitjes dhe në veçanti të organizimit urbanistik.

Projekti ideor i KOMPLEKSIT TË PISHINAVE është koncipuar sipas modeleve më të avancuara të qendrave sportive-rekreative. Qëllimi është që përmbajtjet dhe pajisjet që janë projektuar, të ofrojnë përveç mundësisë së zhvillimit të sportit aktiv të notit, edhe kënaqësi rekreative,

zbavitje etj. Përmbajtjet e pishinës janë të projektuara ashtu që ato të janë në shfrytëzim për të gjithë grupmoshat si dhe kategoritë tjera të vizitorëve.

Me një ofertë atraktive dhe zhvillim të aktiviteteve të llojllojshme si dhe me ofrim të shfrytëzimit të pishinës gjatë tërë ditës, si rrjedhim ky projekt do të rezultonte me profit dhe arsyetim të investimit.

Organizimi i parterit në raport me objektet formojnë një tërësi organike me vlerë të lartë, në formimin e panoramës dhe peisazhit arkitektonik.

Gjelbërimi ka një trajtim të veçantë dhe të konsiderueshëm në zgjidhjen urbane të kompleksit të pishinave, gjegjësisht të kompleksit rekreativ-sportiv.

Rregullimi i jashtëm trajton sipërfaqet si park me gjelbërim të ulët, të mesëm dhe të lartë. Platotë, shtigjet, trotualet, vendpushimet e rekreusëve dhe vizitorëve tjerë, të gjitha këto sipërfaqe janë trajtuar në harmoni me destinimin e përmbajtjes dhe arkitekturës së objektit dhe kompleksit në tërësi.

Pishina e mbyllur është unike për përmbajtjet që ofrohen në rrethinën e ngushtë dhe të gjërë. Duke pas parasysh nevojat dhe gjendjen e konkurrencës në rrethinë, potenciali i plasmanit të realizimit të këtij projekti – investimi, është shumë i sigurt.

7. SISTEMI KONSTRUKTIV DHE APLIKIMI I MATERIALEVE, EKSTERIERIT, ENTERIERIT

Objekti i Pishinës së mbyllur, është projektuar në sistemin konstruktiv skeletor. Elementet tjera konstruktive janë si në vijim:

- **Themeli** - është i sistemit pllakë,
- **Muret e bodrumit** - nga beton armeja,
- **Shtyllat** - nga beton armeja,
- **Trajet** - nga beton armeja,
- **Meskatet** - janë pllaka masive monolite nga beton armeja,
- **Muret e jashtme** - nga beton armeja ($t=25$ cm).
- **Muret e brendshme** - muratohen me blloqe me mure të lehtësuara të argjilës të pjekur ($t=20$; 25 cm dhe $t=12$ cm).
- **Fasadat** - sistemi i kombinuar. Muret e jashtme të objektit të veshura me panele termike. Kurse pjesët tjera të objektit të mbyllura me fasadë gjysmë-strukturale.
- **Kulmi** - është i pjerrët me konstruksion metalik/kapriatë hapësinore dhe mbulesë senduiç nga lllamarina e profiluar dhe e plastifikuar.

Përpunimi i hapësirave si dhe materialet e aplikuar në projekt janë si në vijim:

- **Suvatimi** - Muret e brendshme të projektuara të suvatohen me llaç industrial. Patinimi dhe dekorimi duhet të punohet me makinë.
- **Ngjyrosja** – muret dhe plafonët janë të projektuara të ngjyrosen me ngjyrë disperzive.
- **Dyshemetë** – të vishen me epoxid, beton, pllaka qeramike, granit artificial, laminat, të gjitha këto në varësi funksionit të hapësirës dhe ambientit të objektit ashtu siç janë të specifikuar në fazën grafike të projektit ideor

- Tavanet - e hapësirave janë projektuar si plafone të lëshuara, me konstrukcion metalik.
- Zdrëktbësia - të projektuar në harmoni me rregullat kundër zjarrit. Dritaret; të projektuar nga profilet e termialuminit. Dyert e jashtë dhe hapësirat komunikuese, nga profilet e termialuminit. Dyert e brendshme të hapësirave si në projekt, nga konstrukcioni dhe fitezat e paneleve të drurit.
- **Konstrukcioni i gardhit dhe grillat e gardhit të shkalleve** - të projektuar nga elementet metalike me shkalie të percaktuar të sigurojë sipas normave teknike të projektimit dhe të ndërtimit.
- Pajisjet - sipas përshkrimeve të instalimeve.

instalimet

- **infrastruktura teknike** - instalimet e ujësjellesit, kanalizimit, Instalimet e rrjetit primar telefonik/internet dhe instalimet elektrike, do të kËgen në rrjetin e afert ekzistues.
- **Shfrytëzimi racional i energjisë** - Për një përdorim sa më racional të energjisë", gjatë projektimit janë përfillë normat dhe standardet për projektimin dhe ndërtimin e objekteve të kategorisë së tillë.
 - « **Mbrojtja kundër zjarrit** - Pasi që objekti i projektuar i përket objekteve të karakterit publik gjatë projektimit i është kushtuar kujdes edhe funksionimit të sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit.
 - * Sistemi i ventilimit dhe ajrosjes dhe sistemi i ngrohjes qendrore

8. REAZIMI I PROJEKTIT

Realizimi dhe finalizimi i teresishëm i projektit rekreativ sportiv të Kompleksit të pishnave është planifikuar deri në gjysmën e dytë të vitit 2020.

Pasi realizimi i tij është planifikuar me fazë dhe në rast se procedurat e tij rumbullakësohen dhe përmbillen brenda afatëve të arsyeshme ligjore dhe nëve startojmë me realizimin e punimeve në fillim të tetorit të vitit 2016 atëherë sezonit të I-re veror dmth gjatë vitit 2017 do të jetë e gatshme një fazë për lëshimin në shfrytëzim për qytetaret,

Gjatë realizimit të plotë të projektit kryesor mund të paraqiten modifikime në raport me projektin ideor gjithnjë me qëllimin kryesor të arritjes së zgjidhjes sa më funksionale të objektit si dhe ngritjes së vlerave arkitektonike të objektit dhe vlerave urbane të kompleksit. Duke pas parasysh kompleksin i pishnave duhet dhe do të ketë shtrirje pjesërisht në pronën e Kuvendit Komunal dhe pjesërisht në pronën e Hidroekonomisë së ujërave atëherë shpresojmë që Kuvendi Komunal do të na ndihmojë dhe lehtësojë procedurat edhe me Hidroekonominë e ujërave të Kosovës.


PËRSHKRIMI TEKNIK

Objekti: Kompleksi rekreativ-sportivi notit

Projektues: LIN-PROJEKT shpk, Mitrovicë

Lokacioni: Fidanishte, Mitrovicë

Viti: 2016



HYRJE

Sipas planit rregullues urban "Fidanishte" në Mitrovicë është paraparë hapësira për sport dhe rekreacion në afërsi të stadiumit olimpik të qytetit dhe propozimi për qendrën e sportive-rekreative të pishinës për rregullimin e hapësirave publike.

Duke u nisur nga fakti se në të qytetit nuk ka një objekt për organizim dhe zhvillim të garave në sportine notit dhe me këtë arësyeshmëria investive për kompleksin rekretivo-sportiv të notit do të plotësoi nevojën për këtë lloj sporti, që ka një traditë në këtë qytet.

Me këtë zgjidhje ideore që do të mundësoj formimin e dokumentacionit për qasje në fonde ose sponsor të ndryshëm për avancimin e standardeve publike.

Duke u nisur se ky lokacion i pishinës në Fidanishte është në një lokacion të veçantë në kuadër të qytetit të Mitrovicës paraqet një program ambicioz në rregullimin e hapësirave publike të qytetit me traditë në fushën e sporteve ujore me këtë edhe afirmimi i makro dhe mikro zonës për sport dhe rekreacion në këtë pjesë të qytetit.

LOKACIONI

Objekti rekreativ-sportiv i pishinës është planifikuar të vendoset në Mitrovicë, në lagjen Fidanishte. Lokacioni është i destinuar për sport dhe rekreacion në kuadër të Planit Rregullues Urban "Fidanishte", një hapësirë e njohur për qytetin e Mitrovicës që me përmbajtje dhe rregullim do të plotësoi qëndrimin kualitativ në hapësira të lira të qytetit. Hapësira ka një sipërfaqe prej ... ha dhe është e kufizuar:


- në pjesë veriore me lumin Ibër
- në pjesën lindore me lagjen e romëve
- në pjesën jugore me hapësirën e destinuar për sport

Kjo hapësirë e njohur për qytetin e Mitrovicës me qasje të përshtatshme si hapësirë publike në raport me pozitën në qytet, me përmbajtje dhe rregullim do të plotësoi qëndrimin kualitativ në hapësira të lira të qytetit.

Morfologjia e terrenit është e rrafshët me një rënie të lehtë në pjesën veriore nga lumi Ibër. Lokacioni sot është gjendje të parregulluar dhe për momentin jashtë shfrytëzimit. Në parcelë nuk ekzistojnë objekte i cili do të rrënohet dhe nuk ka gjelbërim të vlefshëm për ruajtje dhe mbrojtje.


Lokacioni për ndërtimin e pishinës ka një pozitë shumë të mirë në kudër të qytetit dhe i takon zonës mjaft atraktive buzë lumit Ibër dhe kompleksit të stadiumit olimpiq. Kushtet e insolimit në këtë lokacion janë shumë të favorshme, sepse mundësojnë qasje në të gjitha anët.

Lokacioni i mëposhtëm tregon situacionin e gjërë të pozitës së parcelës ndërtimore në kuadër të qytetit Mitrovicë.




Situacioni i gjerë (marrë nga Google Earth)

Parcela e caktuar për ndërtimin e objektit afarist-banimor ka formë të rregullt dhe ka shtrirje veriperëndimore-juglindore. Objekti do të ketë qasje kryesore në rrugën publike në anën veri-perëndimore. Kompeksi rekreativ-sportiv i notit është e integruar në shëfitorën buzë lumit Ibër



Situacioni (marrë nga Google Earth)




Situacioni i kompleksit rekreativ të notit

DISPOZITA DHE DESTINIMI I HAPËSIRAVE

Sipas projektit është paraparë ndërtimi i objektit rekreativ-sportiv i pishinës, respektivisht ndërtimi i pishinave të mbyllura dhe të hapura me zgjidhje të integruar në ambient gjelbërimi në vazhdimësi të zonës së lumit Ibër.

Pishina është një strukturë për shumë qëllime që do të përfshijë të gjitha kategoritë shoqërore e posaçërisht personat me nevoja të veçanta.

Hyrja kryesore në objekt është nga pjesa veri-lindore nga rruga publike. Kjo hyrje shërben për shfrytëzuesit e pishinës dhe spektatorët. Qasja është e lehtë për të gjithë shfrytëzuesit pasi edhe terreni është i rrafshët nuk kemi pjerrinë dhe pengesa për qasje të personave me aftësi të kufizuara.



Baza e përdhësës së pishinës së mbyllur

Përdhesa është e planifikuar për aktivitete sportive-rekreative me hapësira të brendshme të ndara të pishinës për gara, pishinës për larje të lirë dhe këndin për larje të fëmijëve. Në hollin reprezentativ hyrës janë pjesa ndarëse për spektatorë dhe për rekreues-vizitor të pishinës me të gjitha kthinat e nevojshme (garderoa, zhveshtore, nyje sanitare, eti).

Pishina për gara është me dimensione gjysëmolimpike me gjatësi 25 m dhe me 8 shtigje për garues. Pranë pishinës olimpike është edhe pishina për rekreacion dhe për fëmijë.

Zgjidhja mundëson funksionim teknologjik dhe organizativ për qëndrueshmëri ekonomike përmes rekreacionit, argëtimit, etj. dhe shfrytëzim fleksibil të hapësirës së pishinës. Mbi hapësirën e restorantit është planifikuar hoteli për vizitor që e rritë vlerën e kompleksit rekreativ të notit.

Në kuadër të lokacionit të pishinës janë paraparë edhe pishina të hapura, restoranti dhe hapësira për terrene të hapura sportive dhe rekreative, si dhe hapësira të mjaftueshme të gjelbra për vizitues, përmbajtjet këto që e ngritin kualitetin e qëndrimit në këtë hapësirë.

Hyrjet në objekt janë të ndara për pjesën e vizitorëve të pishinës së mbyllur dhe hyrja e veçantë për pjesën e pishinave të hapura me gardërobat e veçanta. Në kuadër të pishinës së mbyllur janë edhe hapësirat e tribunave për 1200 spektatorë, hyrja e të cilëve është e veçantë në objekt.

Në objektin e pishinës janë paraparë hyrjet për vizitor dhe ato të veçanta për spektatorë. Numri i përgjithshëm i spektatorëve është rreth 1200 ulëse të vendosur në pjesën e tribunave teleskopike dhe në pjesën e galerisë. Hyrjet për vizitorët e pishinave janë të pajisura me pjesën e gardërobave dhe pjesëve përcjellëse të sanitareve.

Në hapësirat e jashtme janë planifikuar edhe tri pishina të hapura prej të cilave njëra është për pishina olimpike me dimensione 50 x 25m, me 10 shtigje për gara sportive. Pishinat tjerakanëformë të lirë janë të destinuara për vizitor - rekreues, me pjesën për lojëra për fëmijë dhe tobogan. Në kuadër të këtij grupimi është edhe pishina për kërcime në ujë me lartësitë standarde për kërcime në ujë.

Në hapësirat e jashtme përpos pishinave të hapura janë edhe objektet përcjellëse hotelerike. Bar-restoranti është i vendosur në pjesën jugore me qasje të përshtatshme edhe nga hapësirat rekreative të kompleksit të notit, që plotëson kualitetin e qëndrimit të vizitorëve në pishinë. Poashtu në pjesën jugore është vendosur restoranti me qasje edhe nga rruga publike.

Në hapësirat e jashtme është e planifikuar edhe pishina karakteristike me ujë në lëvizje. Furnizimi me ujë bëhet përmes kanalit për furnizim me ujë nga liqeni në afërsi.

Në hapësirat e hapura të lokacionit janë të vendosura edhe fushat e vogla të sporteve si tenis, basketboll, etj. Një vlerë e veçantë janë edhe hapësirat e lira të gjelbëruara që ofrojnë një kualitet për vizitorë. Në disa vende janë të vendosura edhe këndet e lojërave për fëmijë.

Prania e vegjetacionit të lartë, bimëve dekorative ti përshtaten terrenit me mirëmbajtje të lehtë dhe të rregullt. Zgjedhja e fondit bimor që janë autoktone, lloje të cilat janë dëshmuar si të qëndrueshme në këtë territor.

Kompleksi rekreativ - sportiv i notit në konceptin dhe formësimin e vet është në pajtim me parimet bashkëkohore të sipërfaqeve gjelbëruese urbane që respektojnë dhe përmirësojnë llojllojshmërinë biologjike, sjell një vlerë në pamjen e qytetit dhe plotëson kualitetin e hapësirës së qytetit.

ELEMENTET KONSTRUKTIVE TË OBJEKTIT

Sistemi konstruktiv i objektit të pishinës së mbyllur olimpike është me kapriata hapësinore metalike me sistem të kombinuar nga betoni i armuar.

Konstruksioni i kapriatatave hapësinore metalike janë të lidhura me kapriata metalike sekondare në objektin e pishinës. Pjesa hyrëse e objektit ku janë kthinat për vizitor, garderobat, sanitaret, etj. si dhe pjesa e tribunave për spektator janë brei konstruksioni të betonit të armuar me elemente të

shtyllave dhe të pllakave. Muret ndarëse janë të punuara prej blloqeve të lehtësuara të argjilës.

7

PUNËT PËRFUNDIMTARE

Muret punohen me blloqe me vrima të argjilës me dimensione standarde.

Fasada e objektit është e punuar prej elementeve të fasadës strukturale prej xhami që mundëson ndriçim të mirë të hapësira të objektit.

Sipërfaqet e brendshme të dyshemesë së pishinës punohen me pllaka të qeramikës me kualitet të klasit të parë. Gjithashtu edhe vet muret e pishinave vishen me pllaka qeramike.



Të gjitha materialet për izolim duhet të sipas standardeve dhe normave teknike. Punimet e hidroizolimit përfshijnë të gjitha izolimet vertikale dhe horizontale në objekt.


Objekti në fjalë do të kyçet në rrjetin telefonik, elektrik, ujësjellës dhe kanalizimit të qytetit sipas planit rregullues "Fidanishte". Përdorimi i instalimeve elektrike me synim të përdorimit sa më racional të energjisë elektrike me këtë edhe shfrytëzimin më efikas të energjisë elektrike. Pajisjet e përdorura në këtë objekt do të jenë në funksion të kursimit të energjisë dhe të ujit. Grumbullimi të ujit atmosferik në hapësira të caktuar në kuadër të parcelës do të mundësoi pos tjerash edhe ujitjen e gjelbërimit dhe pastrimin e parterit në parcelë.


KOMUNIKACIONI

Qarkullimi publik është i rregulluar sipas Planit Rregullues Urban "Fidanishte" dhe me këtë edhe profilet e rrugëve publike dhe me këtë sigurojnë qasje kualitative për automjete dhe këmbësor. Për qasje të këmbësorëve është me rëndësi të veçantë edhe shëtitorja buzë lumit Ibër në pjesën veri-perëndimore e cila është në kuadër të qasjes dhe ofron një ambient atraktiv

Sipas zgjidhjes së situacionit është bërë zgjidhja e komunikacionit në qetësi - parkingut për kompleksin e rekreacionit-sportit të notit, që ka qasje të përshtatshme nga rruga publike në pjesën lindore dhe veriore.







LOKACIONI:		MITROVICË	
EMRI I PROJEKTI:			
KOMPLEKSI REKREATIV SPORTIV			
PISHINA OLIMPIKE			
J.N. IRIJA	-PERMBAJTJA-		
02	PLANI I SITUACIONIT		
Date: 2016			